



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-13418/2023

Klinë, datë 18/09/2023

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28 më datën 04.06.2008, dispozitat e nenit 14 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit, Nr.08/L-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performances Komunale dhe Skemën e Garantëve të Bazuara në Performancë, dispozitat e nenit 7 paragrafi 3 dhe 4 si dhe nenit 8 të Rregullores së MPL-së nr.01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performances Komunale dhe Skemës së Grantit të Performances Komunale, nenit 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës, të dt.07.04.2010, si dhe kërkesën e MAPL-së, Kryetari i Komunës së Klinës, **mori këtë;**

V E N D I M

Për caktimin e koordinorit për performacë komunale

1. **DRILON MORINA**, Asistent Administrativ në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, **CAKTOHËT**, Koordinator për performancë të Komunës së Klinës.
2. Koordinator për performancë është përgjegjës për koordinimin e procesit të raportimit me zyrtarët raportues të fushave të SMPK-së, zbatimin e kritereve për verifikim dhe raportimin e të dhënave të cilat i dërgohen kryetarit të komunës për miratim, pastaj MAPL-së.
3. I përmenduri punët dhe detyrat i kryen në përputhje me rregullativën ligjore pozitive.
4. Më rastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi, nr.01-031-4370/2016 i datës 17.10.2016.
5. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- MAPL-ja;
- Zyrtarët përgjegjës raportues;
- Ekzekutivi, si dhe;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun ELEZAJ